



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

Nr. 23, datë 29.04.2020

PËR
MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 2'635'200 LEKË, TË AKORDUAR
NGA ORGANIZATA UNICEF NË SHQIPËRI, PËR FAMILJET NË NEVOJË, SI
NDIHMË FINANCIARE PËR SHKAK TË GJËNDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE
COVID-19

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr.236, datë 19.03.2020 “Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social në Bashkinë Durrës, me propozim të Zëvendëskryetarit Bashkisë, i cili kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :


1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 2'635'200 lekë, të akorduar nga Organizata UNICEF në Shqipëri, për familjet në nevojë, si ndihmë financiare për shkak të gjëndjes së fatkeqësisë natyrore COVID-19.
2. Ngarkohen Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Shërbimit Social në Bashkinë Durrës për zbatimin e këtij vendimi
Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

U shpall sot me datë 29 / 04 / 2020

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 335 / Prot.
3

Durrës, më 30/4 2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 23, datë 29.04.2020 “Për miratimin e përdorimit të fondit prej 2’635’200 lekë, të akorduar nga organizata UNICEF në Shqipëri, për familjet në nevojë, si ndihmë financiare për shkak të gjëndjes së fatkeqësisë natyrore COVID-19”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që më jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

